



SHERBIMI SOCIAL

#2023 ME ADMINISTRATORËT SHOQËRORË



Ditët e para të vitit të ri 2023 kanë nisur me takime me administratorët shoqëror në të gjithë Shqipërinë.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Xholi, e nisi nga Fieri, ku u ndanë arritjet e vitit të kaluar, si edhe u diskutuan sfidat e përbashkëta për zbatimin me sukses të Programeve të Mbrojtjes Sociale.

#PAKO-JA E MADHE



Ky vit ka nisur me mbështetjen e menjëhershme financiare për shumë kategori, duke përfshirë familjet me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, gratë kryefamiljare me tri fëmijë etj.

Kjo Pako e Madhe do të shërbejë për të lehtësuar barrën e inflacionit në familjet shqiptare.



SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Janar 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për disa prej DRSHSSH dhe është në proces për disa të tjera.

Janë ndjekur dhe monitoruar grupet rajonale lidhur me integrimin në punë të anëtarëve madhorë të familjeve me NE.

#SHTËPIA E TË MOSHUARVE TIRANË

Karolina dhe “Primera Group”, miq të dashur të gjyshërve tanë na surprizuan me dhuratat e tyre. Kjo kohë e ftohtë do të përballohet më mirë në sajë të paneleve diellore më të reja në shtëpinë tonë.

Mirënjohje për Karolinën dhe miqtë e familjes sonë të cilët janë si gjithnjë solidarë ndaj të moshuarve.

